

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	OVl e UÇK-së: BE-ja veç çka s'po thotë mos na pengoni t'i dënojmë krerët se në Apel i lirojmë
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/ovl-e-uck-se-be-ja-vec-cka-spo-thote-mos-na-pengoni-ti-denoj-me-kreret-se-ne-apel-i-lirojme
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 00:56:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:24:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2c133231589ea67b404ab0eee2b7bb7a06d94e310c81029da280deb5a9ba567a
TEKSTI	dd93a3411702cfacc606ab7f9cd324cbb99d0503469c996b37e8a6356f70693a
PAMJA	69f9b642c01e7b9df198fec6fd25fca504475b2fca3963d9ad6078f1de5e8494

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	600e67248795e68d9871bdbb85141d2d4e725afa92ac032a104415ca09888e38
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc70e080b3a4a4c4cbf64bcb131092a1f212b073abe7679f17bd0bd0d647616
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/600e67248795e68d9871bdbb85141d2d4e725afa92ac032a104415ca09888e38>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

ARBËRI

OVL e UÇK-së: BE-ja veç çka s'po thotë mos na pengoni t'i dënojmë krerët se në Apel i lirojmë



13 shtator 2026 18:24

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka thënë se shumë ambasadorë të huaj dhe Bashkimi Evropian, në përpjekje për ta menaxhuar pakënaqësinë qytetare për Gjykatën Speciale, ka thënë se me 16 shtator nuk përfundon gjithçka sepse palët e kanë edhe instancën e Apelit.

Bashkimi Evropian ka kërkuar nga të gjitha shtetet dhe palët që të respektojnë vendimin e Dhomave të Specializuara ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së dhe ka vënë në pah gjithashtu se vendimi i 16 shtatorit nuk është fundi i procesit gjyqësor dhe se ai mund të apelohej nga të dyja palët.

Sipas OVL UÇK-së, vetëm sa nuk po e thonë direkt që në Apel do t'i shpallim të pafajshëm andaj mos na pengoni t'i dënojmë një herë.

"Shumë ambasadorë të huaj, sikurse dje edhe BE-ja, në përpjekje për t'i menaxhuar pakënaqësitë qytetare lidhur me Gjykatën Speciale, po thonë: më 16 shtator nuk përfundon gjithçka, sepse palët e kanë Apelin. Veç çka nuk po thonë direkt: "Mos na pengoni t'i dënojmë një herë, sepse në Apel i shpallim të pafajshëm". Kjo është një lojë e pistë politike me shkallët e drejtësisë. Gjykata Speciale, që nga fillimi, u ka raportuar diplomatëve, sepse është krijuar dhe mbështetur prej tyre. Ajo nuk ka vepruar asnjëherë si një institucion i pavarur i drejtësisë", ka thënë OVL UÇK-ja.

Tutje është thënë se Serbia nuk e pret Apelin dhe se menjëherë do ta përdorë një vendim të tillë në OKB, në diplomaci e në përpjekjet e saj për ta delegjitimuar Kosovën si shtet.

"Bashkësia ndërkombëtare e ka tradhtuar besimin e Kosovës, sepse ia ka tjetërsuar misionin dhe qëllimin Gjykatës Speciale. Ajo nuk duhet ta humbasë edhe atë që ka mbetur mes nesh. Vendimi i padrejtë nuk sjell paqe, por konflikt. Dhe kushdo që sot po luan me këtë zjarr, nesër nuk mund të thotë se nuk e dinte çfarë po bënte. Drejtësia nuk mund të jetë e drejtë vetëm në fund. Ajo duhet të jetë e drejtë qysh në fillim. Prandaj, APELI që veteranët e UÇK-së ia drejtojnë BE-së dhe ambasadorëve të huaj është që të mos bëjnë politikë me vendimin e 16 shtatorit në

Futboll.

Çfarë thotë Edon Zhegrova?

Shtojca për Kulturë.

Mark Tirta – etnologu i terrenit, dijes dhe kujtesës shqiptare

Futboll.

Torresi në superformë i siguron PSG-së tjetër fitore

Futboll.

DAZN: Heroi i mbërmbjes ishte Arianjet Muriq

Arbëri.

14 shkolla në proces të mbylljes, shkak i rënies së numrit të nxënësve

Kronikë.

Vëzhgimi me dronë, Policia në Gjakovë për 5 ditë pezulloi 152 patentë shoferë dhe shqiptoi 774 gjoba

Gjykatën Speciale”, është thënë mes tjerash.

#OVL UÇK

#KRERET E UÇK-SË

#GJYKATA SPECIALE

#BASHKIMI EVROPIAN

Artikuj të ngjashëm

- 

Arbëri

• 27 kor 2026

Konjufca i bën thirrje Speciales: Mos merrni vendim politik, por të drejtësisë
- 

Arbëri

• 1 kor 2026

OVL-UÇK paralajmëron protesta, s’e përjashton përshkallëzimin
- 

Arbëri

• 6 maj 2026

Valë reagimesh kundër vendimit të Speciales për shtyrjen e aktgjykimit
- 

Arbëri

• 6 maj 2026

PDK: Shtyrja e aktgjykimit për ish-krerët e UÇK-së, goditje ndaj drejtësisë dhe besimit publik
- 

Arbëri

• 18 shk 2026

Në OVL-UÇK e konsiderojnë të vonuar angazhimin e shtetit kundër procesit në Hagë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimet për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i Ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.